



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr._____, datë_____

PËR

PROPOZIMIN KUVENDIT PËR LIRIMIN E NJË ANËTARI,
TË CAKTUAR KRYETAR, TË KËSHILLIT DREJTUES
TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE
DHE POSTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 116, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin Kuvendit për lirim të z. Ilir Zela, anëtar, i caktuar kryetar, i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDESKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

RELACION

PËR

VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROPOZIMIN KUVENDIT PËR LIRIMIN E NJË ANËTARI, TË CAKTUAR KRYETAR, TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE”

Z. Ilir Zela është zgjedhur nga Kuvendi anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Gjithashtu, z. Ilir Zela është zgjedhur nga Kuvendi kryetar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i ka përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave njoftimin për dorëheqjen e z. Ilir Zela, anëtar, i caktuar kryetar, i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Vendimi parashikon propozimin Kuvendit për lirim të z. Ilir Zela, anëtar, i caktuar kryetar, i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Vendimi bazohet në nenin 116, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike dhe postare”, të ndryshuar.

KËSHILLI I MINISTRAVE